

**UDC 304-027.511**

Atifete Thaqi, Ma

Besarta Jusaj, Ma

Duresa Bobaj, Ma<sup>1</sup>

## **GLOBALIZIMI**

## **ГЛОБАЛИЗАЦИЈАТА**

## **GLOBALIZATION**

### **Abstract**

Globalization is the process of international relations that has to do with the interchange of goods, ideas and other aspects of culture in the different parts of the world. The process of globalization helps countries that are located in the different parts of the world stay connected to each other in the aspect of finance and trade. Nowadays the term globalization is very popular for companies which seek the policy of expanding overseas.

Today globalization represents a widely spread phenomenon whose consequences are felt in all places, starting from those places which belong to a higher scale of development, to those which are in an ongoing process of expansion. Being a result of technological advances in transport and communication, globalization has spread its effect in all the fields such as: political, economical, social and cultural. Globalization is present in International Trade, Direct Foreign Investments and in Capital Trading which recently have been the ones to dominate. Globalization represents an inevitable phenomenon in the history of mankind which is making our world look ‘smaller’ in the sense of exchanging goods, services, knowledge, and cultures between countries.

Countries are connected to each other through globalization. They are no longer isolated but rather independent when it comes to fulfilling their political requirements. They depend on one – another. When discussing globalization, we must not forget to mention the

---

<sup>1</sup> Master of Economic Sciences, Accounting and Finance, University “Haxhi Zeka” in Peja  
e-mail: [fetja\\_91@hotmail.com](mailto:fetja_91@hotmail.com) , [besartajusaj@outlook.com](mailto:besartajusaj@outlook.com) , [buressa.bobaj@hotmail.com](mailto:buressa.bobaj@hotmail.com).

interdependence. This may be something new, or it might have existed a long time ago, however, there was no clear definition. Anyway, interdependence is not global.

Keywords: globalization, consequences, effects, forms, interdependence

### **Abstrakt**

Globalizimi është intensifikimi i marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes të cilave vende të largëta mbajnë lidhje me njëra-tjetrën, në mënyre të tillë që ngjarjet në një vend karakterizohen nga të njëjtat procese sikurse edhe në një vend tjetër shumë kilometra larg, dhe anasjelltas. Globalizimi përdoret edhe në mënyre argumentuese për ndryshime të dëshiruara në politikë dhe ekonomi. Kjo shërben për inskenimin e shndërrimit politik.

Globalizimi përfaqëson sot një dukuri gjithëpërfshirëse, pasojat e të cilit janë të ndjeshme në të gjitha vendet, si në ato të zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim e sipër. Duke qenë rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike në transport e komunikacion, globalizimi e ka shtrirë efektin e tij në të gjitha fushat, si në atë politike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj. Tre format kryesore të shfaqjes së tij janë: tregtia ndërkombëtare, investimet e huaja direkte dhe integrimi i tregjeve të kapitalit, niveli i të cilave ka ardhur vazhdimisht duke u rritur vitet e fundit.

Globalizimi përfaqëson një dukuri të paevitueshme në historinë e njerëzimit, që po e bën botën gjithnjë e më të vogël nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të mallrave, shërbimeve, informacionit, njohurive dhe kulturave midis vendeve të ndryshme.

Globalizimi nuk përmban thjesht rreze veprimi, por edhe varësi. Shtetet janë të lidhura me njëri-tjetri. Ato nuk janë më të izoluara por janë të pavarura kur bëhet fjalë për plotësimin e kërkesave të tyre politike. Ato varen nga njëri tjetri. Nëse flitet për globalizimin atëherë nuk mund të lihet pa përmendur ndërvarësia. Kjo mund të jetë diçka e re ose mund të ketë ekzistuar kohë më parë por nuk ka pasur një përcaktim të saktë. Por edhe sot ndërvarësia nuk është globale.

Fjalët kyçe: globalizimi, pasojat, efektet, format, ndërvarësia.

## Hyrje

Globalizimi është një zhvillim i cili diskutohet në mënyrë më kontroverse. Për simpatizuesit e saj, në rend të parë është rruga në drejtim të një ekonomie me eficiente dhe largimi i pengesave të konkurrencës dhe tregut. Me fenomenin e globalizimit lidhen shumë aspekte. Ky emërtim edhe pse duket të përdoret vitet e vonshme, bënë fjalë për një zhvillim i cili qëndron thellë në të kaluarën dhe përmbyll një sërë aktivitetesh që tejkalojnë kufijtë e një shteti. Këtu bëhet fjalë për një proces i cili ka rrjedhë gradualisht dhe që kishte ndikim nga forcat më të ndryshme. Duhet bërë dallimin midis termave globalizëm (globalism) dhe globalizim - globalizacion (globalization). Globalizimi, në thelb përshkruan dhe shënon jo më tepër së një botë e cila karakterizohet me rrjete të lidhjeve që i kapërcejnë hapësirat multi-kontinentale, përkundër kësaj globalizimi shënon rritjen apo zvogëlimin në një shkallë të globalizimit, i cili përqendrohet në forcat, dinamizimin apo shpejtësinë e këtyre ndryshimeve. Globalizimi përshkruan realitetin e të qenurit i ndërlidhur, kurse globalizimi përfshin shpejtësinë në të cilën këto lidhje shtohen apo pakësohen.<sup>2</sup>

Globalizimi është një çështje mjaft e rëndësishme që i është kushtuar vëmendje e veçantë. Globalizimi është një term që haset shpesh qoftë në biseda të ndryshme e media, me pak fjalë në tëra sferat e jetës, por fjala globalizim paraqet vështirësi kur na duhet të japim të qartë e të saktë kuptimin e tij. Globalizimi është një dukuri me ndikim shumë të madh në të gjitha zhvillimet ekonomike, sociale, politike, karakteristike për fundin e shekullit të XX. Globalizimi është zhvillim i tregut dhe ekonomisë botërore dhe nënkupton të ashtuquajturën “botë pa kufij”.

Termi i globalizimit tregon drejt por jo shumë qartë, se pozicioni i shtetit në fund të shekullit XX ka ndryshuar në mënyrë të dyfishtë. Ai mbulohet nga proceset e ndërvarësisë, që i mundësojnë një shteti të arrijë qëllimet e veta vetëm atëherë kur shtetet e tjera bashkëpunojnë. Një definicion tipik mundë të merret nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMNose IMF), i cili e thekson ndërvarësinë ekonomike gjithnjë në rritje të vendeve rreth e përçark botës përmes shtimit të vëllimit dhe shumëllojshmërisë së transaksioneve tej-kufitare

---

<sup>2</sup> Joseph Nye, "Globalism Versus Globalization".

në mallra e në shërbime, rrjedhjen e lirë ndërkombëtare të kapitalit si dhe shpërndarjen tejte të shpejtë e të gjerë të teknologjisë.<sup>3</sup>

Ata që globalizimin e vlerësojnë si një zhvillim pozitiv, parimet bazë të tij i përmbledhin nën këta tituj: shekullarizimi, demokracia liberale, ekonomia e tregut të lirë dhe shteti juridik kushtetues. Disa të tjerë këtë e shprehin më shkurtër me treshin e termave: në fushën e së drejtës, revolucioni “i të drejtave njerëzore”: në fushën e politikës, demokracia liberale dhe në fushën e ekonomisë, ekonomia e tregut të lirë dhe prodhimi i mbështetur në konkurrencë”.<sup>4</sup>

### **Historiku i globalizimit**

Si term “globalizimi” ka filluar të përdoret qysh në vitin 1994, mirëpo ekonomistët kanë filluar ta aplikojnë kah viti 1981. Termi “fshat global” u afirmua pas botimit të veprës *Understanding Media* (Routledge, Londër, 1964) nga autori M. McLihan. Ndërkaq Theodore Levitt është meritori për termin “globalizim” përmes një artikulli të tij që ai e shkroi në vitin 1983 për *Harvard Business Review* të titulluar “Globalization of Markets (“Globalizimi i tregjeve”).<sup>5</sup>

Në trajtimin e historisë së globalizimit, disa autorë më shumë fokusohen në ngjarjet që nga viti 1492, mirëpo shumica e dijetarëve e teoricienëve përqendrohen në një të kaluar shumë më të afërt. Ndërkaq shumë më herët se viti 1492, njerëzit kanë filluar t’i lidhin bashkë vendet e ndryshme të globit në sisteme të gjera të komunikimit, migrimit e të ndërlidhjes. Ky formim i sistemeve të ndërveprimit midis globales dhe lokales ka qenë një forcë motivuese kryesore në historinë botërore. Të këtilla kanë qenë rastet si: përhapja dhe shtrirja e religjioneve botërore, hinduizmi, budizmi, xhainizmi, sihizmi, taoizmi, konfuçionizmi, jehudizmi, krishterimi, islami etj.; “rruga e mëndafshit” (silk road), ekspansioni i Xhingis Kanit, Aleks; krijimi i perandorive të mëdha botërore; zbulimi i kontinenteve tjera të botës; dekolonizimi etj.<sup>6</sup>

---

<sup>3</sup> IMF Staff, “Globalization Threat or Opportunity”, 2000.

<sup>4</sup> Mehmet S. Aydın Kuresellesmeye Genel Bir Bakış”, në: grup autorësh, *Siyasi, Ekonomik ve Kulturel Boyutanyla Kresellesme*, ufuk Kitaplari, Stamboll, 2002, faqe 13.

<sup>5</sup> Mehmet S. faqe, 11. ”

<sup>6</sup> “A Quick Guide to th World Hystory of Globalization”

“ . . . Standardi i arit është një sistem monetar në të cilin njësia ekonomike standarde për llogari është një peshë e fiksuar e arit.

. . . Liberalizimi shënon para së gjithash një lirim dhe zbutje të kufizimeve të mëhershme qeveritare, zakonisht në fushën e politikës sociale apo ekonomike. <http://en.wikipedia.org>

“Epoka e parë e globalizimit “ ka filluar me periudhën e standardit të arit “ dhe të liberalizimit” në shek. XIX. E mbështetur në Pax Britannica dhe në këmbimin e mallrave, kjo epokë është e zhvilluar bashkë me industrializimin. Kjo epokë thuhet se dobësohet në fazat e fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe përfundon me krizën e standardit të arit në vitet e vona 1920 dhe në fillim të viteve 1930.

Që nga Lufta e Dytë Botërore e këndej globalizimi është lëvizur nga raundet e negociatave mbi tregtinë, fillimisht nën patronazhin e GATT-it, që kanë çuar në një seri të marrëveshjeve për ngritjen e kufizimeve në tregtinë e lirë. Pastaj raundi i Uruguait (1984-1995) ka çuar të marrëveshja për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT ose WTO), për të ndërmjetësuar në mosmarrëveshjet tregtare. Me qëllim të reduktimit të tarifave e të pengesave tregtare janë nënshkruar edhe një sërë marrëveshjesh dy e më shumëpalëshe, përfshirë këtu edhe Marrëveshjen e Mastrohitit (Maastricht Treaty) në Evropë dhe Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Amerikën Veriore (The North American Free Trade Agreement-NAFTA).<sup>7</sup>

### **Natyra, përkufizimi dhe ekzistenca e globalizimit**

Globalizimi përfaqëson një dukuri të paevitueshme në historinë e njerëzimit, që po e bën botën gjithnjë e më të vogël nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të mallrave, shërbimeve, informacionit, njohurive dhe kulturave midis vendeve të ndryshme. Ai përbën gjithashtu edhe çështjen më të diskutuar e shpesh më të kritikuar të dekadës së kaluar, që ka qenë subjekt i librave dhe kërkimeve të panumërta, si dhe shkak i një sërë demonstrimesh të fuqishme në SHBA dhe Evropë (Banka Botërore, 2002). Megjithatë, pavarësisht përdorimit të gjerë të këtij termi duket se ende nuk ekziston një përkufizim i saktë dhe gjerësisht i pranueshëm i tij. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit se termi në vetvete përmbledh një sërë dimensionesh si, dimensionin ekonomik, atë politik, dimensionin shoqëroro-kulturor dhe atë mjedisor. Kështu Bhagwati (2004) e përshkruan globalizimin si procesin gjatë të cilit njerëzit unifikohen në një shoqëri të vetme, një proces ky që kombinon forcat ekonomike, politike e shoqëroro-kulturore me ato teknologjike.

---

“GATT (The General Agreement on Tariffs and Trade – Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë [e jashtme])

<sup>7</sup> NAFTA –The North American Free Trade Agreement (Marrëveshja për Tregti të Lirë e Amerikës Veriore) është e themeluar në janar të vitit 1994 nga Kanadaja, SHBA-ja dhe Meksika dhe përbën rajonin më të madh në botë të tregtisë së lirë <http://www.nafta-see-alena.org>

“The global Scenario group është themeluar në vitin 1995 nga The Stockholm Environment Institute për të angazhuar një grup të dalluar e të ndryshëm ndërkombëtar në një shqyrtim të prospekteve për zhvillim botëror në shekullin 21, me gjerësisht shih: [www.gsg.org](http://www.gsg.org)

Ndërkohë, sipas Harris (1995 f. 80) “globalizimi në përgjithësi i referohet integritetit mbarëbotëror të njerëzimit apo ngjeshjes në kohë dhe hapësirë të bashkëpunimit midis njerëzve në mbarë botën”. Giddens (1990 f. 64), bazuar në teorinë moderne mbi shoqërinë, e përkufizon globalizimin “si intensifikim të marrëdhënieve shoqërore të cilat lidhin lokalitete të distancuara në mënyrë të atillë, që ndodhitë kombëtare të krijohen dhe ndikohen nga ngjarje të ndodhura disa milje larg apo anasjelltas”.

Po kështu, Scholte (2000) nënvizon që, si rrjedhojë e zhvillimit të telekomunikacionit, kompjuterëve digjitalë, mediave audiovizuale e të tjerave si këto, ngjarjet globale mund të ndodhin sot pothuajse njëkohësisht në të gjitha vendet e botës. Sipas tij, ky kuadër plotësohet akoma më tepër nga rritja e shkallës së liberalizimit në mjedisin ndërkombëtar, nëpërmjet reduktimit të barrierave të vendosura nga shtetet ndaj lëvizjes së tregtisë, kapitaleve dhe njerëzve (Scholte, 2000).

Dy fushat kryesore ku ndikimi kopje 2 i globalizimit është më i ndjeshëm janë: globalizimi i tregjeve dhe globalizimi i prodhimit (Wild et al., 2003; Hill, 2005, 2007). I pari ka të bëjë me prirjen e kompanive për të lëvizur nga një sistem ekonomik ku tregjet kombëtare janë të izoluara, si rrjedhojë e pengesave tregtare, gjeografike dhe kulturore që i karakterizojnë, drejt një sistemi ku këto tregje konvergojnë në një të vetëm, të quajtur treg global (Levitt, 1983; Wild et al., 2003; Czinkota et al., 2005, Graham & Cateora, 2006; Hill, 2005, 2007). Ndërsa globalizimi i prodhimit përfaqëson shpërndarjen e aktiviteteve prodhuese në vende të ndryshme me qëllim për të përfituar nga ndryshimet në koston dhe cilësinë e faktorëve të prodhimit ndërmjet vendeve (Wild et al, 2003; Hill, 2005, 2007).

Ekzistojnë diskutime të shumta akademike rreth asaj nëse globalizimi është një fenomen i vërtetë apo thjesht është vetëm një artefakt (mit) analitik. Edhe pse termi në fjalë është mjaft i përhapur, shumë autorë thonë se karakteristikat që i vishen globalizimit sot janë vërejtur edhe më herët në kohë të ndryshme të historisë. Pra, shumë ka që thonë se këto tipare, përfshirë edhe rritjen në tregtinë ndërkombëtare si dhe rolin gjithnjë më të madh të korporatave multinacionale, nuk janë ngulitur aq thellë sa mund të duket së janë. Termin internacionalizim disa autor e parapëlqejnë më shumë sesa termin globalizim, tek internacionalizimi, roli i shteteve dhe rëndësia e kombeve janë të mëdha, ngase globalizimi në formën e tij complete i eliminon shtetet kombëtare, ata pohojnë së kufijtë e shteteve, në kuptimin më të gjerë, janë larg ngritjes së tyre totale prandaj edhe ky proces i globalizimit nuk ndodh dhe më siguri edhe nuk do të ndodh, duke marrë parasysh se në historinë botërore

internacionalizimi kurrë nuk është shndërruar në globalizim (Bashkimi Evropian dhe NAFTA akoma janë duke e provuar rastin e tyre). Ndërsa, autorë të tjerë thonë se jemi duke kaluar në një fazë planetare të qytetërimit; forma dhe karakteri i saktë i shoqërisë globale po kontestohet dhe kjo do të përcaktohet nga zgjedhjet që do t'i bëjmë në dekadat e ardhshme kritike. Për shembull, The Global Scenario Group (Grupi i Skenarit Global) ka skicuar mendime alternative për të ardhmen globale me ç'rast "forcat e tregut" ose globalizimi ekonomik janë vetëm njëri opsion, i vënë përball "reformës në politikë", "bota kala", "shkatërrimit", "eko-komunalizimit" dhe një "paradigme të re vazhdimësie".<sup>8</sup>

Zhvillimet teknologjike e kanë bërë shumë më të lehtë dhe shumë më pak të kushtueshëm transferimin e të dhënave, produkteve, pajisjeve dhe njerëzve nga njëri vend në tjetrin, madje edhe ndërmjet distancave të largëta. Kjo si rrjedhojë u ka krijuar mundësi kompanive të zgjerojnë aktivitetin e tyre në shumë tregje nëpërmjet formave të ndryshme të hyrjes. Teknologjia e internetit dhe aplikimi i tregtisë elektronike kanë ndryshuar proceset e shitblerjes dhe po lehtësojnë vendosjen dhe mbajtjen e lidhjeve të forta të kompanive me klientët, furnitorët dhe partnerët e tyre strategjikë, pavarësisht nga vendndodhja e tyre.

Gjithashtu, kontrolli dhe koordinimi i aktivitetit të filialeve të shpërndara në tregje të ndryshme realizohet më lehtësisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të sofistikuar që përshpejtojnë rrjedhjen e informacionit (Wild et al., 2006) e si rrjedhojë edhe marrjen e vendimeve. Liberalizimi i tregtisë dhe formave të tjera të aktivitetit ndërkombëtar përbën burimin e dytë të globalizimit. Procesi i liberalizimit të tregtisë mori përmasa akoma më të mëdha mbas Luftës së Dytë Botërore me krijimin në vitin 1947 nga 23 vende të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat, sot Organizata Botërore e Tregtisë, e cila ka për qëllim reduktimin e barrierave tarifore dhe jo tarifore në tregtinë e të mirave dhe shërbimeve ndërmjet vendeve. Por, përpjekjet integruese nuk përfunduan me kaq, madje, edhe pse te kufizuara brenda rajoneve të caktuara, ato u paraqitën akoma më ambicioze. Mjafton të përmendim Bashkimin Evropian, i cili sot numëron 27 shtete anëtare, ndërmjet të cilave mallrat, shërbimet dhe faktorët e prodhimit lëvizin lirshëm, apo Zonën e Tregtisë së Lirë ndërmjet SHBA-së, Kanadasë dhe Meksikës, e cila pretendon të bashkohet me aleanca të tjera ekonomike në Kontinentin e Amerikës Latine për të krijuar Zonën e Tregtisë së Lirë ndërmjet Amerikave. Duhet përmendur gjithashtu edhe roli i padiskutueshëm i Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar në nxitjen e tregtisë dhe marrëdhënieve

---

<sup>8</sup> Shih web faqen Global Issues That Affect Everyone: [www.globalissues.org](http://www.globalissues.org)

ekonomike ndërkombëtare, përmes asistencës financiare e teknike siguroar vendeve të ndryshme dhe përpjekjeve për të krijuar e mbajtur një sistem monetar ndërkombëtar sa më të qëndrueshëm (Eitman et al., 2007).

Ndryshimet e ndodhura në institucione dhe organizata përfaqësojnë një tjetër faktor me rëndësi për zhvillimin e dukurisë së globalizimit. Përparimet teknologjike dhe liberalizimi i tregjeve të produkteve dhe faktorëve të prodhimit kanë stimuluar shumë kompani që të zgjerojnë aktivitetin e tyre përtej vendeve origjinë, në kërkim të tregjeve më të mëdha, burimeve me kosto më të ulët dhe fitimeve më të larta. Ato drejtohen nga menaxherë me një vizion të gjerë, që vazhdimisht janë në ndjekje të oportuniteteve të reja të biznesit në tregun vendas e sidomos në atë të huaj.

Edhe organizatat jofitimprurëse apo organizmat e rëndësishëm ndërkombëtarë si Kombet e Bashkuara, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore operojnë tashmë mbi bazën e një perspektive globale, duke shërbyer si agjentë të ekonomisë së re globale. Gjithashtu, ndryshimet në mjedisin politik dhe ideologjik në mbarë botën kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë efektet e tyre në zgjerimin e globalizimit. Rënia e murit të Berlinit, e ndjekur nga përmbysja e sistemeve ekonomike të centralizuara në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, i dha fund një ndarjeje ideologjike shumëvjeçare mes Lindjes dhe Perëndimit.

Ky ndryshim ka kontribuar së pari në krijimin e një mjedisi ideologjik global pro vlerave të ekonomisë së tregut dhe tregtisë së lirë, dhe së dyti, në rivendosjen e marrëdhënieve ekonomike midis Lindjes dhe Perëndimit duke i dhënë kështu një shtysë tjetër proceseve globalizuese e jo vetëm atyre me karakter ekonomik. Së fundi, janë zhvillimet kulturore në vende të ndryshme të botës ato që përbëjnë burimin tjetër të globalizimit. Mundësia për të lëvizur e komunikuar më shpejt e më lirë ka rritur bashkëveprimin midis individëve nga vende me kultura të ndryshme, duke zgjeruar kështu shkëmbimet ndërmjet këtyre kulturave.

### **Format e shfaqjes së globalizimit**

Ky aktivitet shfaqet kryesisht në këto tre forma: tregti ndërkombëtarë, investime të huaja direkte dhe integrim i tregjeve të kapitalit (Banka Botërore, 2002). Përvoja botërore në fushën e tregtisë ndërkombëtare ka vërtetuar dhe po vërteton se tregtia e lirë mes vendeve të ndryshme dhe jo krijimi i monopolit të shtetit mbi tregtinë e jashtme, që u zbatua në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, përfshirë dhe vendin tonë, përmban në vetvete elementë



nxitës për drejtimin e burimeve të një vendi në ato sektorë dhe degë të ekonomisë në të cilat ai ka avantazhe konkurruese.

Gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e vazhdueshme në vëllimin e tregtisë botërore të mallrave dhe shërbimeve. Kështu, sipas raportit të Organizatës Botërore të Tregtisë “World Trade Report 2013”<sup>9</sup>, norma mesatare vjetore e rritjes së vëllimit të eksporteve botërore të mallrave për periudhën 2005-2012 është 4.5%. Vëllimi i investimeve të huaja direkte ka pësuar rritje të dukshme gjatë dekadës së kaluar, si rrjedhojë e reduktimit të barrierave për lëvizjen e kapitalit në shumë vende të botës. Kështu, këto investime u rritën nga 324 miliardë \$ në vitin 1995 në 1,5 trilionë \$ në vitin 2000 (Banka Botërore, 2002). Por, klima politike dhe ekonomike e krijuar në fillim të viteve 2000 pas sulmeve të 11 Shtatorit, pati efektet e veta në reduktimin e këtyre ritmeve.

Pasiguria ekonomike dhe politike çuan në një rënie të ndjeshme të nivelit të investimeve të huaja direkte në rajone të caktuara, e sidomos në atë të Amerikës Veriore dhe asaj Jugore. Megjithatë, viti 2003 shënoi një fazë tjetër në tendencën e këtyre investimeve, fluksi i të cilave erdhi vazhdimisht në rritje për të mbërritur nivelin e 1,3 trilionë \$ në vitin 2006, shifra e dytë rekord e regjistruar ndonjëherë për këtë tregues në shkallë botërore pas asaj të vitit 2002 (UNCTAD, 2007).<sup>10</sup>

### **Dimensionet e globalizimi**

Globalizimi është intensifikimi i marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes të cilave vendet e largëta mbajnë lidhje me njëra tjetrën, në mënyrë të tillë që ngjarjet në një vend karakterizohen nga të njëjtat procese edhe në një vend tjetër shumë kilometra larg, dhe anasjelltas.<sup>11</sup>

Globalizimi mund të thuhet se është një proces që prek të gjitha fushat e jetës së njeriut. Është identifikuar me një numër prirjesh, që përfshijnë një lëvizje më të madhe ndërkombëtare të të mirave, të parave, të informatave e të njerëzve, si dhe përfshijnë zhvillimin e teknologjisë, organizatave, të sistemeve juridike e të infrastrukturës që e lejojnë dhe mundësojnë një lëvizje të tillë. Dimensionet e globalizimit janë: ekonomia, politika, kultura, mjedisi, shoqëria

<sup>9</sup> [http://www.wto.org/english/res\\_e/booksp\\_e/world\\_trade\\_report13\\_e.pdf](http://www.wto.org/english/res_e/booksp_e/world_trade_report13_e.pdf)

<sup>10</sup> [http://www.unctad.org/en/docs/wir2007\\_en.pdf](http://www.unctad.org/en/docs/wir2007_en.pdf)

<sup>11</sup> Anthony Giddens

dhe konsiderohet si përpjekje për ndërkombëtarizimin e tregtisë ku shënoi hapin e parë, konkretisht drejt globalizimit.

**Niveli ekonomik-** në nivelin ekonomik globalizimi shfaqet në: rritjen e tregtisë ndërkombëtare në një shkallë shumë më të shpejtë sesa rritja e ekonomisë botërore, shtimin e rrjedhjes ndërkombëtare të kapitalit përfshirë edhe investimet e jashtme direkte, lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë shkaktuar krijimin e organizatave WTO (Organizata Botërore e Tregtisë) dhe të karteleve ekonomike siç është OPEC, rritjen e rolit të organizatave ndërkombëtare siç janë WTO, WIPO, IMF, që merren me transaksione ndërkombëtare.<sup>12</sup>

Sa i përket dimensionit ekonomik mund të thuhet se ai qëndron në plan të parë në shtypin e ditës ku trajtohen çështje të ndryshme si rritja shumë e madhe e tregtisë dhe investimeve direkte, globalizimi i tregjeve financiare si shembull parade, prodhimi i integruar ndërkombëtar, sipërmarrje ndërkombëtare, konkurrenca lokale e shteteve dhe rajoneve, fundi i ekonomive kombëtare. Globalizimin nuk duhet konceptuar thjesht si një proces ekonomik por si një proces që ndërlidh në vetvete një sërë dimensionesh që e bën atë një forcë të rëndësishme lëvizëse.

Risite teknologjike e posaçërisht në fushën e informacionit dhe të komunikimit luajnë një rol qendror, veçanërisht interneti i cili në shumë pikëpamje duket si shëmbëlltyra e globalizimit.

**Niveli politik-** Politika e organizuar sikurse edhe më parë kryesisht në nivel territorial dhe kombëtar ka mbetur prapa në krahasim me ekonomin e organizuar gjithnjë e më tepër në mënyrë ndërkombëtare apo globale, e çliruar nga kufijtë dhe materia. Shpesh politikanët globalizimin e përdorin si argument për të arritur synimet e tyre, mirëpo globalizimi nuk është përgjegjësi i vetëm për gjithçka që ndodh.

---

<sup>12</sup> \*WTO- The World Trade Organization është organizata e vetme globale internacionale e cila merret me rregullat e tregtisë midis kombeve. Themeluar në Gjenevë të Zvicrës me 1 janar 1995. Më gjerësisht shih [www.wto.org](http://www.wto.org).

\*OPEC –The Organization of the Petroleum Exporting Countries (Organizata e Vendeve transportuese të naftës) është organizatë e përhershme, ndërqeveritare e themeluar në Konferencën e Bagdatit 10-14 shtator 1960, nga ana e Iranit, Irakut, Kuvajtit, Arabisë Saudite dhe Venezuelës. Më gjerësisht shih [www.opwc.org](http://www.opwc.org).

\*WIPO-The World Intellectual Property Organization (Organizata botërore e Pronësisë Intelektuale) është një agjenci e specializuar e kombeve të Bashkuara. Është themeluar nga Konventa WIPO në vitin 1967 me një mandat nga shtete anëtare për të promovuar mbrojtjen e pronësisë intelektuale në mbar botën përmes bashkpunimit midis shteteve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Në gjenevë të Zvicrës gjinden zyrat e kësaj agjencie. Më gjerësisht shih: [www.wipo.int](http://www.wipo.int).

\*IMF –The International Monetary Fund (Fondi Monetar Ndërkombëtar) është themeluar në vitin 1945 për t'i ndihmuar shëndetit të ekonomisë botërore. Zyrat e tij gjenden në Uashington DC, ai udhëhiqet dhe mban përgjegjësi përpara 184 vendeve të cilat e përbëjnë anëtarësinë e tij pothuajse globale. Më gjerësisht shih, [www.imf.org](http://www.imf.org).

**Niveli shoqëror** - Globalizimi si nocion sot ka shumë përkufizime, të disa teoricien social, por janë edhe disa faktorë që kanë ndikuar në zhvillimin e shpejtë të globalizimit si: zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, hapja e kufijve dhe shkëmbimi i mallrave pa pengesë i ofruan globalizimit një zhvillim sa më të shpejt, globalizimi lindi si rezultat i zhvillimeve të brendshme të teorisë sociale si reagim kundër perspektivave më të hershme.<sup>13</sup>

Globalizimi është bërë një ideologji<sup>14</sup> planetare që ka ndihmuar në zgjidhjen e shumë komplikimeve nga ana e ekonomisë. Globalizimi është procesi i ndërvarësisë më të madhe ndërmjet vendeve dhe qytetarëve të tyre. Globalizimi përfshin edhe elemente joekonomike, si kultura dhe mjedisi.

**Niveli i mjedisit**- Problemet globale si ngrohja e atmosferës së tokës, pastaj vrma e ozonit apo degradimi i pyjeve e bëjnë të qartë globalizimin në natyrën më mbresëlënëse, pasi këtu bëhet fjalë pa diskutim për problemet globale, të cilat kanë nevojë për një trajtim global, e megjithëse në aspektin e mjedisit natyrisht ka edhe probleme lokale e rajonale.

**Niveli kulturor**- Në nivelin kulturor globalizimi shfaqet në shkëmbimin kulturor gjithnjë më të madh ndërkombëtar, pastaj përhapjen e multikulturalizimit si dhe pranimin më të mirë individual në shumëllojshmërinë kulturore, mund të marrim eksportimin e filmave të Hollywood-it dhe Bollywood-it të cilat mund të shikohen në tërë botën. Por kultura e importuar lehtë mund t'ia zë vendin kulturës lokale.

**Niveli politik**- Politikanët shpesh e përdorin globalizimin si argument për të arritur synimet e tyre. Politika e organizuar sikurse edhe më parë kryesisht në nivelin territorial dhe kombëtar ka mbetur prapa në krahasim me ekonominë e organizuar gjithnjë e më tepër në mënyrë ndërkombëtare apo globale. Andaj politikës i duhet të përballet me probleme më masive, globalizimi dhe konkurrenca lokale kufizojnë hapësirën e veprimit për politikën kombëtare, prandaj duhet të gjenden forma dhe arena të tjera të politikës për t'i dhënë zgjidhje këtyre problemeve.

Globalizimi ka bërë që rritja ekonomike në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim të përmirësohet apo të përkeqësohet, në gjithë botën ekziston një debat i gjerë nëse globalizimi ka bërë që rritja ekonomike në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim të përmirësohet apo të përkeqësohet, shumica e vendeve të paglobalizuara përfshijnë vendet më të varfra, pabarazitë

---

<sup>13</sup> Andrew Heywood, Politika, 2008, f. 140

<sup>14</sup> Fjala ideologji nënkupton një grup njerëzish të cilët kanë ide pak a shumë të përbashkëta për organizimin e një veprimi politik. Andrew Heywood, Politika, 2008, f. 405

në të ardhurat për frymë dhe në standardet e jetesës ndërmjet vendeve të paglobalizuara nga njëra anë, si dhe vendeve të globalizuara dhe të pasura nga ana tjetër, janë bërë më të theksuara. Shpesh thuhet se madje edhe terrorizmi ka pësuar një globalizim, me sulme në vendet e jashtme që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me vendin amë.<sup>15</sup> Mendime e sidomos deklarata të këtilla sot dëgjohen nga shumë politikanë anekënd botës, “lufta kundër terrorizmit global” etj.

### **Matja e globalizimit**

Një qasje shumë e sofistikuar për matjen e globalizimit është indeksi bashkëkohor i kalkuluar nga instituti zviceran për hulumtime (think tank) KOF<sup>16</sup>. Indeksi në fjalë i mat tre dimensionet kryesore të globalizimit, atë: ekonomik, social dhe politik.

Krahas tre tregueseve për matjen e këtyre dimensioneve, kalkulohet edhe një indeks i përgjithshëm i globalizimit dhe nën-tregues që i referohen rrjedhave informative si dhe të dhënave rreth lidhjeve kulturore për kontakt personal, të dhënave rreth rrjedhave informative si dhe të dhënave rreth lidhjeve kulturore.

Të dhënat jepen në bazë vjetore për 122 vende. Sipas këtij indeksi, vendi më i globalizuar në botë është SHBA-ja, e pasuar nga Suedia, Kanada, Mbretëria e Bashkuar dhe Luksemburgu. Vendet më pak të globalizuara sipas indeksit të KOF-it janë Togoja, Çadi dhe Republika e Afrikës Qendrore.

### **Problemet e globalizimit**

Globalizimi na prek të gjithëve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Një rol qendror luan vlerësimi objektiv i mundësive dhe rreziqeve.

---

<sup>15</sup> Poter. K, "The Future of Terrorism", dhe Maskaliunaite. A "Terrorism and globalization"

<sup>16</sup> KOF Konjunkturforschungsstelle: [www.kof.ch/globalization](http://www.kof.ch/globalization).

Globalizimi është një dukuri shumëdimensionale. Teknologjitë e informacionit bashkë me një sërë teknologjish të tjera po zhvillohen me shpejtësi dhe po përhapen gjerësisht. Tregtia po zgjerohet në mbarë botën po kështu dhe qarkullimi i kapitalit dhe investimeve private. Ndërvarësitë po shtohen në çdo fushë të jetës sonë.

Sido qoftë këto zhvillime po krijojnë pika të dobëta si dhe po mbjellin farën e dhunës dhe konfliktit. Krizat ekonomike shtrihen nga njeri shtet në tjetrin dhe po sjellin situata globale të vështira.

Të gjitha këto janë pjesë e asaj çka zakonisht i referohemi me emrin “globalizim” dhe të gjitha këto sjellin pasojat për sigurinë<sup>17</sup>.

### **Rreziqet ndërkombëtare**

Aspektet e shumta të globalizimit ndërlidhen dhe kështu rriten rreziqet për një sërë kërcënimesh ndërkombëtare që nga prodhimi i armëve, pirateria në internet, trafiku i drogës përhapja e sëmundjeve ngjitëse, krimi global. Rreziku më i njohur është ai i rritjes së temperaturës globale, e cila shkakton thatësira shkatërruese, pastaj përmytje dhe stuhi të forta, mirëpo mund të cekim se rreziqe të tjera për mjedisin janë edhe ndotja e ajrit, ujit, zhdukja e pyjeve, biodiversitetit.

Të gjitha këto kërcënime ndërkombëtare shpesh duket se janë të shpërndara dhe të paqarta, meqenëse marrëveshjet mungojnë, dhe qeveritë po bëjnë pak për tu dhënë atyre përparësi apo për të ndjekur strategji parandaluese të besueshme, një çështje është nëse komuniteti ndërkombëtar mund të përballojë marrjen e këtyre rreziqeve.

Zvogëlimi i ngrohjes globale varet nga ndryshimet që duhet të bëhen në aktivitetet njerëzore si djegia e karburantit, gazolinës dhe qymyrit. Përveç vëzhgimit global dhe sistemeve vepruese, shpërndarja e ilaçeve dhe barnave mjekësore atje ku mungojnë, është thelbësore për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.

Parandalimi i dhunës etnike varet nga të kuptuarit e shkaqeve të saj në çdo shtet, nga krijimi i sistemeve të këshillimit në zbatimin e politikave të duhura, parandalimin e një konflikti si dhe nëse është e nevojshme edhe ndërhyrje nga jashtë<sup>18</sup>.

---

<sup>17</sup> Robert o. Keohane and Joseph S. Nye, Jr. ,”Introduction,”in Joseph S. Nye and John D. Donahue, editors Governance in a GlobalizinWorld, Washington, D. C. Brookings Instituion Press, 2000.

Ndërmarrja e këtyre strategjive në praktikë d.m.th. që qeveritë dhe bizneset privatë të marrin masa të reja dhe të kushtueshme për sigurinë e sistemeve të tyre të informacionit, qeverive do ju duhet të shtrinin rregulloret brenda vendit dhe të përballeshin me humbjet tregtare që rrjedhin si pasojë e reduktimit të përhapjes së toksikëve të efektit serë. Atyre do t'u duhet që të gjenin burime të tjera përveç atyre që janë vënë në dispozicion në luftën ndaj sëmundjeve ngjitëse deri më tani.<sup>19</sup>

### **Proglobalizimi (Globalizimit)**

Mbështetësit e 'globalizimit demokratik' shpeshherë quhen edhe proglobalistë, të cilët konsiderojnë se faza e parë e globalizimit, e cila ka qenë me orientim tregtar, duhet të kompletohet nga një fazë e ngritjes së institucioneve globale politike që do ta përfaqësojnë vullnetin e 'qytetarëve botërorë'.

Dallimi prej globalistëve të tjerë është se këta nuk përcaktojnë paraprakisht ndonjë ideologji që do ta drejtonte këtë vullnet, çka i lihet zgjedhjes së lirë të këtyre qytetarëve përmes një procesi demokratik.

Mbështetësit e tregtisë së lirë theksojnë se teoritë ekonomike të 'përfitimit komparativ' sugjerojnë që tregtia e lirë çon në një akordim efektiv të burimeve, me çka të gjitha vendet e involvuara në këtë tregti do të përfitojnë. Marrë në përgjithësi, kjo shpie te çmimet më të ulëta, punësimin më të madh dhe rendimentet më të larta.

Disa nga kritikët theksojnë se lëvizja antiglobaliste përdorin dëshmi anekdotike për t'i mbështetur pikëpamjet e saj dhe se statistikat gjithëbotërore në të vërtetë e mbështesin fort globalizimin, përqindja e njerëzve që në vendet në zhvillim jetojnë me të ardhura nën 1 \$ amerikanë në ditë është përgjysmuar brenda vetëm njëzet viteve, edhe pse disa kritikë janë të mendimit se duhen studiuar me mirë e më thellë ndryshoret për matjen e varfërisë.<sup>20</sup>

---

<sup>18</sup> Charles King "The myth of Ethnic Warfare," *Foreign Affairs*, November/December 2011, f. 165-170.

<sup>19</sup> *Washington Post*, Janar 31, 2002.

<sup>20</sup> Chossudovsky. M, *Global Falsehoods: How the World Bank and the UNDP Distort the Figures on Global Poverty* ".

## Antiglobalizimi (Drejtësia globale)

Kritikët në mënyrë tipike theksojnë se globalizimi është një proces që diktohet nga imperativët e elitës, dhe në mënyrë tipike e diskutojnë mundësinë e institucioneve dhe politikave alternative globale, të cilat, besojnë ata, do të adresojnë kërkesën morale të klasave të varfëra e punëtore anekënd globit si dhe shqetësimet për mjedisin në një mënyrë shumë më të drejtë.

Sa i përket çështjes së diskutueshme mbi migrimin global, diskutimet rrotullohen rreth dy pikave: rreth shkaqeve, në çfarë mase migrimi global është vullnetar apo jovullnetar, i domosdoshëm apo jo i domosdoshëm, dhe rreth pasojave, nëse është kjo e dobishme, apo ka ndonjë çmim shoqëror dhe ambiental. Ihtarët e globalizimit priren ta shikojnë migrimin thjeshtë si një proces me ç'rast punëtorët jakëbardhë dhe jakëblu mund të shkojnë nga një vend në tjetrin për t'i kryer shërbimet e tyre, ndërkaq kritikët priren t'i theksojnë rastet negative si pasiguria ekonomike, politike dhe ambientale, dhe si një efekt të dukshëm negativ e citojnë lidhshmërinë midis migracionit dhe rritjes enorme të lagjeve të varfra në vendet në zhvillim.<sup>21</sup>

Ka një sërë llojesh të antiglobalizimit, në përgjithësi, kritikët thonë se rezultatet e globalizimit nuk janë ato që janë predikuar kur kanë filluar përpjekjet për shtimin e tregtisë së lirë, dhe se shumë institucione të involvuara në sistemin e globalizimit nuk i kanë marrë në konsideratë interesat e popujve të varfër, klasën punëtore si dhe ambientin.

Disa grupe antiglobaliste pohojnë se globalizimi pashmangshëm ka një karakter imperialistik, është njëra prej arsyeve shtyese të luftës në Irak dhe i detyron kursimet që të rrjedhin drejt SHBA-ve e jo drejt vendeve në zhvillim e sipër, andaj mundë të thuhet se globalizimi në këtë kuptim është një term tjetër për një formë të 'amerikanizimit', saqë nga disa vrojtues besohet se SHBA-të mund të jenë njëri nga shumë shtetet që vërtet përfitojnë nga globalizimi.

Disa aktivistë të antiglobalizimit e kundërshtojnë faktin se "globalizimi" aktual i globalizon paratë dhe korporatat, e jo edhe njerëzit dhe sindikatat. Kjo mund të vërehet në kontrollin e rreptë të migrimit në pothuajse të gjitha shtetet, si dhe nga mungesa e të drejtave të punëtorëve në shumë vende të botës në zhvillim e sipër.

---

<sup>21</sup> UN-HABITAT, "Cities and globalization: A Race of the Bottom".

## Conclusion

We can say that the process of globalization is a phenomenon which is deeply spreading its effect in all the cultures of the environment that surrounds us. Globalization has made it possible for the companies to expand overseas and to grow economically and financially. Globalization is a multidimensional process which is increasing everyday and more. Globalization has pulled the economy to another direction. For example, we can see how 'Coca-Cola' being one of the most famous drink, has the same features throughout all the countries and people all over the world like the product. Some automobiles use parts from other countries as in a car being assembled in the United States with the parts coming from Japan, Germany or Korea. Food is one factor of globalization. One can find people eating sushi on Peru or Indian food in Europe.

Globalization has had its impact in technology as well, for example, cell phones connect people all over the world like never before. As we can see, globalization has had its influence in all real life's fields. One of the most important effects of globalization has been the expansion of merchandise, from local to international; as a result of this, many companies have open their factories in those countries where the labor work is much cheaper and the employees are greater in number. As an outcome of this, companies manage to decrease the cost so that they can increase the profits to a higher degree. Some researchers consider that despite its advantages globalization has its disadvantages as well. A negative side can be that the developed countries can stifle the development and underdevelopment countries. Then, economic depression in one country can trigger adverse reaction across the globe etc.

Economical dimension is of a great importance. It serves as a stirring force in other fields as well. Globalization requires new ways of reaching continuity in the upcoming decades.



## Përfundimi

Mund të themi se procesi i globalizimit është një fenomen i cili është thellësisht i përhapur, globalizimi ka shtrirë efektin e vet në të gjitha kulturat e mjedisit që na rrethon. Globalizimi ka bërë të mundur për kompanitë për t'u zgjeruar jashtë shtetit dhe që të rriten ekonomikisht dhe financiarisht.

Globalizimi është një proces multidimensional i cili është në rritje të përditshme gjithnjë e më shumë. Globalizimi ka tërhequr ekonominë në një tjetër drejtim për shembull, ne mund të shohim se si "Coca-Cola" të qenurit një nga pijet më të famshme, ka karakteristika të njëjta në të gjithë vendet dhe njerëzit e përdorin në të gjithë botën si produkt pastaj disa automobila përdorin pjesë nga vende të tjera për ndonjë makinë duke u mbledhur në Shtetet e Bashkuara me pjesët që vijnë nga Japonia, Gjermania apo Koreja. Ushqimi është një faktor i globalizimit, dikush mund të gjen njerëz që përdorin sushi në Peru apo ushqim indian në Evropë.

Globalizimi ka pasur ndikim në teknologji, për shembull, telefonat celularë kanë lidhur njerëzit në gjithë botën si kurrë më parë. Siç mund të shohim, globalizimi ka pasur ndikim në të gjitha fushat e jetës reale. Një nga efektet më të rëndësishme të globalizimit ka qenë zgjerimi i mallrave, që formojnë lidhjen lokal në atë ndërkombëtar si rezultat i kësaj, shumë kompani kanë hapur fabrika e tyre në ato vende ku kostoja e punës është shumë më e lirë dhe të punësuarit janë më të mëdha në numër. Si rezultat i kësaj, kompanitë arrijnë të ulin koston në mënyrë që ata mund të rrisë fitimet për një shkallë më të lartë. Disa studiues mendojnë se pavarësisht nga avantazhet e saj globalizimi ka disavantazhet e saj. Një anë negative mund të jetë se vendet e zhvilluara mund të mbytin vendet në moszhvillim. Pastaj, depresioni ekonomik në një vend mund të shkaktojë reagim të kundërt në të gjithë globin, etj.

Dimensioni ekonomik është i një rëndësie të madhe. Ajo shërben si një forcë nxitje në fusha të tjera. Globalizimi kërkon mënyra të reja për të arritur vazhdimësi në dekadat e ardhshme.

## Referenca

Aisbett, E. (2004), "Why are the Critics so Convinced that Globalization is Bad for the Poor?", NBER Working Paper No. W11066, <http://www.nber.org/papers/w11066>.

Andersen, T. J. & Foss, N. J. (2000), "Strategic opportunity and economic performance in multinational enterprises: The role and effects of information technology", *Journal of International Management*, Vol. 11, 2005, 293– 310.

Banka Botërore (World Bank, 2002), "What is globalization. Assessing globalization. Part one of a four part series",

Banka Botërore (World Bank, 2003), "Does More International Trade Openness Worsen Inequality? Assessing globalization. Part three of a four part series".

Fondi Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund, 2008), "World Economic Outlook, April 2008", <http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2008/01/pdf/text.pdf>.

Bonache, J. & Fernandez, Z. (1999), "Strategic staffing in multinational companies: a resourcebased approach", In Brewster, C. & Harris, H. (Eds), *International HRM: Contemporary Issues in Europe*. New York: Routledge.

Mehmet S. Aydin Kuresellesmeye Genel Bir Bakis", në: grup autorësh, *Siyasi, Ekonomik ve Kulturel Boyutanyla Kresellesme, ufuk Kitaplari*, Stamboll,2002, faqe 13.

Chossudovsky. M, *Global Falsehoods: How the World Bank and the UNDP Distort the Figures on Global Poverty* “.

Robert o. Keohane and Joseph S. Nye, Jr., "Introduction," in Joseph S. Nye and John D. Donahue, editors *Governance in a Globalizme World*, Washington, D. C. Brookings Instituion Press, 2000.

Charles King "The myth of Ethnic Warfare, " *ForeignAffaris*, November/December 2011, faqe 165-170.

Heywood. A, *Politika*, 2008, faqe, 140,405.

Poter. K, *The Future of Terrorism*”, dhe Maskaliunaite. A "Terrorism and globalization”.

Nye. J, "Globalism Versus Globalization”.

IMF Staff,"Globalization Threadt or Opportunity",2000.

Washington Post, Janar 31,2002.

KOF Konjunkturforschungsstelle: [www.kof.ch/globalization](http://www.kof.ch/globalization)

WTO- The World Trade Organization [www.wto.org](http://www.wto.org)

OPEC –The Organization of th Petroleum Exporting Countries [www.opec.org](http://www.opec.org)

WIPO-The World Intellectual Property Organization [www.wipo.int](http://www.wipo.int)

IMF –The Internacional Monetary Fund [www.imf.org](http://www.imf.org)

UN-HABITAT, ”Cities and globalization:A Race of the Bottom”. [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)

Shih web faqen Global Issus That Affect Everyone: [www.globalissues.org](http://www.globalissues.org)